



Pas fitore bindese qe ekipi i Vllaznise arriti ndaj Laçit, trajneri i skuadres Shkodrane, Agim Canaj u shpreh i kenaqur per lojen e skuadres si dhe shpjegoi se skuadra e tij duhet te vazhdoje te permiresohet per te qendruar ne luften per titullin kampion.

"Ne e njohim mire Laçin. Eshte nje ekip i konsoliduar dhe qe ka disa sezone rresht qe merr pjese ne kupat e Evropes. Pikerisht, per keto dhe shume arsye te tjera ne e vleresuem shume ndeshjen. Taktikisht, i bllokuam kundershhtarit tri pikat me te forta te tyre siç jane, Vucaj, Veliaj dhe Brkic. Gjithashtu, ekzekutuam suksesshem shpejtesine e lojtareve tone dhe arrihem te shenonim 3 gola duke sshfrytezuar edhe gabimet e kundershtareve. Entuziazmi po shtohet tek tifozat por duhet te vazhdojme te qendrojme me kembe ne toke sespe takimin e rradhes ne mesjave do te perballemi me Skendertbeun qe eshte 3 here rresht kampion i Shqiperise dhe per te perballuar ekipe te tilla dhe kaq shpesh duhet kontingjent i mire lojtrresh", theksoi Canaj i cili shtoi: "Shpresoj shume qe tifozat ne mesjave te na mbeshtesin ne mase sepse na duhet ngrohtesia e tyre. Ne po treojme qe po punojme seriozisht dhe rezultatet po vijne edhe pse per te folur per titull eshte ende heret. Skenderbeu dhe Kukesi akoma nuk kane shprehur vlerat e tyre reale. Ne duhet ne rrijme sa me afer kreut duke mos gabuar ne ndeshjet tona. Kampionati eshte me tri faza dhe eshte shume i lodhshem. Ekipi ka nevojte per shume gjera, por une po shoh qe cdo dite e me teper entuziazmi po shtohet ne ambjentin kuqeblu dhe drejtuesit po afrohen me ekipin. I bej thirrje tifozave qe te jene te shumte kunder Skenderbeut dhe ne te gjitha ndeshjet sepse kjo Vllazni do ti shperblej perkrahjen e tyre me rezultate. Siç e thash kemi nevojte per tifozat shkodrane sepse jane nje model i tifozllekut dhe fair play-in qe tregojne ne shkallet e stadjumeve. Duhet marre shembull nga ato", perfundoi prononcimin e tij trajneri i Vllaznise pas ndeshjes ndaj Laçit.